

Prishtinë, 15 mars 2007
Kodi i ZRRE-së: D_41_2007

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Ka pranuar aplikacionin nga KOSTT Sh.A. për miratimin e tarifave të reja të propozuara të bartjes, që do të zbatohen nga data 1 prill 2007.

Duke marrë parasysh:

1. Detyrat e veta që dalin sipas neneve 45 dhe 48 të Ligjit Nr. 2004/9 “Për Rregullatorin e Energjisë” dhe, veçanërisht, kërkesat sipas nenit 46.2 se:
 - a) çmimet duhet të jenë të arsyeshme, jo-diskriminuese, dhe të bazuara në kritere objektive si dhe të përcaktuara në mënyrë transparente;
 - b) çmimet varen para së gjithash nga kostot e arsyetuara, duke përfshirë edhe kostot e pambuluara që ndërlidhen me kalimin në tregun konkurrues të energjisë, si dhe duke përfshirë një kthim të arsyeshëm të investimeve;
 - c) Zyrës së Rregullatorit për Energji i lejohet të caktojë çmime të bazuara në shkallën e përmbushjes së performansave;
 - d) ndër-subvencion të aktiviteteve të ndërmarrjeve të integruara nuk do të lejohet;
2. Dispozitat e Rregullës mbi Parimet e Llogaritjes të Tarifave në sektorin e energjisë elektrike (“Rregulla mbi Çmimet”) dhe Metodologjia e Tarifave.
3. Vendimin e Bordit të ZRRE-së të datës 21 dhjetor 2006 (D_29_2006), që përcakton të hyrat e lejuara që do të mblidhen nga KOSTT Sh.A. nëpërmjet të tarifave të rregulluara me pakicë për vitin 2007, në vlerë prej 13.678.000 €.

ka:

1. Ka konfirmuar përputhjen ndërmjet tarifave të transmisionit me të hyrat e lejuara që paraprakisht janë aprovuar nga bordi i ZRRE-së, duke u bazuar që tarifa e re me pakicë do të aplikohet në mes të datës 1 prill dhe 31 dhjetor 2007.

Dhe në seancën e Bordit të mbajtur me 15 mars 2007, ka vendosur të:

1. Apropojë tarifat e bartjes, të bashkëngjitura në këtë vendim, për tu zbatuar nga KOSTT Sh.A nga 1 prilli 2007, ashtu siç janë analizuar nga Bordi i ZRRE-së.

2. Ky vendim do të publikohet nga KOSTT Sh.A në së paku një gazetë ditore që ka qarkullimin më të gjerë në Kosovë, brenda 5 ditëve të punës pas shpalljes dhe publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRrE-së.
3. Ky vendim është nxjerrë në gjuhën shqipe, serbe dhe anglishte. Në rast të kontestit në mes të gjuhëve do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze.
4. Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të dorëzojë ankesën në gjyqin e juridiksionit përkatës brenda 14 ditëve pas miratimit dhe publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së.
5. Ky vendim bëhet i plotfuqishëm me 20 mars 2007.

Bordi i ZRrE-së

Ali Hamiti

Kryesues i Bordit të ZRRE-së

Merita Kostari

Anëtare e Bordit

Theranda Beqiri

Anëtare e Bordit

Naim Bejtullahu

Anëtar i Bordit

Nysret Avdiu

Anëtar i Bordit

Bashkëngjitur: Tarifat e rregulluara të KOSTT Sh.A. të aprovuara

| Tarifat e propozuara (të ndryshuara apo ekzistuese janë ruajtur) | Baza kualifikuese (niveli i tensionit apo natyra e konsumatorit) | Baza e ngarkesës (p.sh. kW/muaj, kWh apo konsumatori) | Ngarkesa njësi sipas tarifës Euro/baza ngarkuese | | |
|--|---|--|---|-------------|-------------|
| | | | 2007 | 2008 | 2009 |
| | | | Aplikimi | Parashikimi | Parashikimi |
| Shfrytëzimi i rjetës së ngarkesës 400 / 220 kV | 400/220 kV | kW/a (ngarkesa e pikut) | 3.119 | 4.795 | 6.642 |
| Shfrytëzimi i rjetës së ngarkesës 110 kV | 110 kV | kW/a (ngarkesa e pikut) | 7.001 | 10.33 | 13.62 |
| Ngarkesa e operimit të sistemit | bartja | MWh | 0.872 | 0.833 | 0.818 |
| Ngarkesa e operimit të tregut | bartja | MWh | 0.013 | 0.013 | 0.015 |